



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 30.01.2021

Nr: 2

VENDIM

PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË MONITORIMIT TË MEDIAS AUDIO DHE
AUDIOVIZIVE

(ndryshuar me vendimin nr. 7 datë 27.1.2022)

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 30.01.2021, me pjesëmarrjen e:

Iirjana	NANO-	Kryetare
Arens	ÇELA-	Anëtar
Dritan	ÇAKA-	Anëtar
Helga	VUKAJ-	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ-	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive.

BAZA LIGJORE: Nenet 20, paragrafi 1, shkronja “ç”, 77,78,80,81,83,84,84/1 85 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

Komisioni Rregullator në zbatim të neneve 20, paragrafi 1, shkronja “ç” 77, 78, 80, 81, 83, 84, 84/1, 85, dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:

VEREN:

Neni 20, paragrafi 1, shkronja "ç", e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e rregullave për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 77 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar, përcakton periudhën e fushatës zgjedhore dhe heshtjen zgjedhore, duke ndaluar çdo lloj fushate në periudhën e heshtjes zgjedhore nëpërmjet organeve të medias apo të veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

Neni 78 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar, përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës duke kushtëzuar dhe kufizuar marrëdhëniet e subjekteve zgjedhore me operatorët radiotelevizivë për transmetimin e veprimtarive të fushatës, mesazheve apo reklamave zgjedhore.

Nenet 80 dhe 81 i ligjit nr. 10019, date 29.12.2008, të ndryshuar, përcaktojnë rregullat për minutazhin falas në dispozicion të subjekteve zgjedhore dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të bërë fushatë, në radiotelevizionin publik, nëpërmjet lajmeve, programeve informative dhe edicioneve informative. Kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pezullimin e transmetimeve në rast se programi nuk është identifikuar qartë si dhe vendosjen e masave ndëshkimore në rast të shkeljeve të kërkesave të përcaktuara në këto nene.

Neni 83 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar, përcakton orarin e transmetimeve për minutazhin në dispozicion të subjekteve zgjedhore.

Neni 84 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar, parashikon pasqyrimin e fushatës zgjedhore në radiot dhe televizionet private vetëm në edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative, duke mos vendosur kohë transmetimi në dispozicion të subjekteve zgjedhore si dhe masat që merr Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në rast të shkeljeve të parashikuara në këtë nen.

Neni 84/1 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar, parashikon mbulimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore, të drejtën e partive politike për të përcaktuar raportet kohore për mbulimin e fushatës për këshillat dhe kandidatët e saj për kryetarë të vetëqeverisjes vendore.

Neni 85 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar, parashikon monitorimin e fushatës zgjedhore në mediat audio dhe audiovizive nga enti rregullator që rregullon, mbikëqyr fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive, pasqyrimin e gjetjeve në raporte të detajuara dhe paraqitjen e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shqyrtimin dhe marrjen e masave ndëshkimore në rast shkeljeve të këtyre dispozitave.

Neni 92 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar; përcakton detyrimin e institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore të raportojnë në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të Zhvillojnë në periudhën katër muaj para zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

PËR KETO ARSYE

Komisioni Rregullator në zbatim të neneve 20, paragrafi 1, shkronja "ç", 77, 78, 80, 81, 83, 84, 84/1, 85 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objektiva dhe qëllime

(ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 7 datë 27.01.2021)

1. Kjo metodologji përcakton procedura dhe teknika të posaçme që ndjek Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore nga ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive (OSHMA).
2. AMA nëpërmjet kësaj metodologjie gjatë fushatës zgjedhore duhet të sigurojë që:
 - i) liria e shprehjes të jetë thelbësore në vlerësimin dhe mbulimin e fushatës zgjedhore nga OSHMA-të
 - ii) OSHMA-të të ofrojnë mbulim që plotëson kriteret për një raportim të ekuilibruar, pluralist dhe të paanshëm;
 - iii) Në rast ankesash, evidentimin e plotë mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjes së standardeve profesionale dhe të etikës gazetareske nga ana e OSHMA-ve;
 - iv) Të mundësohet akses i barabartë dhe trajtim i ndershëm i kandidatëve/subjekteve zgjedhore dhe platformave të tyre.
3. AMA duhet të monitorojë që periudha e publikimit të sondazheve dhe periudha e heshtjes zgjedhore të respektohet nga OSHMA-të.
4. AMA duhet të monitorojë OSHMA-të nëse ato ofrojnë mundësi të mjaftueshme kandidatëve dhe platformave të tyre, për informimin e publikut, në mënyrë jo diskriminuese dhe të paanshme.
5. AMA monitoron zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor për fushatën zgjedhore në OSHMA-të publike dhe private dhe akteve nënligjore të KQZ-së.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Monitorimi i fushatës zgjedhore nga OSHMA-të kryhet në të gjithë territorin e vendit ku zhvillohen zgjedhjet.
2. AMA monitoron zbatimin e rregullave të sanksionuara në Kodin Zgjedhor dhe të akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.
3. Radiotelevizioni Publik Shqiptar dhe OSHMA-të private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë fushatës zgjedhore. Regjistrimet ruhen për një periudhë 10-mujore pas përfundimit të zgjedhjeve dhe vihen në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me kërkesën e këtij institucioni.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "AMA", është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- b) "OSHMA", janë ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive.
- c) "Lloji i medias", është radiotelevizioni publik, radiot dhe televizionet publike dhe private.
- d) "Kampionaturë", është metoda e monitorimit sipas të cilës, bëhet përzgjedhja e OSHMA-ve që do të monitorohen, rezultatet e monitorimeve të të cilave do të përfshihen në raportin ditor të monitorimit.
- e) "Kandidatë të caktuar", janë kandidatet për deputet apo kandidatët për kryetar bashkie dhe këshilltarëve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 4

Monitorimi i publikimit të sondazheve

(Ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 7 datë 27.1.2022)

1. *Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit. Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.*
2. Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositesin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit.

Neni 5

Monitorimi i transmetimit të veprimtarive të ndaluara nga KQZ

(ndryshuar pika 4 me vendimin nr. 7 datë 27.01.2021)

1. AMA pas marrjes dijeni nga faqja zyrtare e internetit të KQZ-së për veprimtaritë publike "Ndaluar nga KQZ-ja", monitoron respektimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nga OSHMA-të publike dhe private.

2. Në rast të paraqitjes së ankesave mbi shkeljen e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga OSHMA jo të përfshirë në monitorim por që përmbajtjet e tij janë të regjistruara, AMA monitoron përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA ndaj të cilit është paraqitur ankesa.
3. Në periudhën para fushatës zgjedhore, AMA monitoron edicionet informative të OSHMA-ve, sipas pikës 1 të këtij neni mbi veprimtaritë e ndaluara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
4. *Për veprimtaritë e institucioneve publike, monitorimi i OSHMA-ve fillon 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe bëhet nga ora 08:00-00:00 ose sipas rastit deri në përfundimin e programit. Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme afati për monitorimin e veprimtarive të institucioneve publike përcaktohet me akt normativ të posaçëm të Komisionit Rregullator.*
5. AMA në rast se konstaton se OSHMA ka transmetuar veprimtari të ndaluara nga KQZ, njofton zyrtarisht Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për marrjen e masave të mëtejshme.

Neni 6 Monitorimi i fushatës zgjedhore

1. Monitorimi i OSHMA-ve publike bëhet sipas këtyre kriterëve:
 - a. Monitorimi i OSHMA-ve publike me shtrirje gjeografike kombëtare, satelitore dhe rajonale që mbulojnë minimalisht 48% të popullsisë bëhet bazuar në këto kriterë:
 - i. Monitorimi i përditshëm TV me format gjeneralist dhe informativ;
 - ii. Monitorimi i përditshëm i edicioneve informative, reklamave/ spoteve, debateve politike, apo programeve të përcaktuara në nenin 7 të këtij vendimi ku janë të ftuar përfaqësues të subjekteve politike/ zgjedhore, kandidatë për deputet/ drejtues të organeve njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - iii. Monitorimi bëhet në të dhëna sasiore dhe cilësore referuar kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të KQZ-së.
 - b. Monitorimi i OSHMA-ve publike me shtrirje rajonale që nuk plotësojnë kriterin e pikës a) bëhet me përzgjedhje në bazë të këtyre kriterëve:
 - i. Zona e ofrimit të shërbimit (mbulimi gjeografik)
 - ii. Audienca;
 - iii. Oraret e transmetimit;
 - iv. Formatit i përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, i përgjithshëm/tematik;
 - v. Lloji i medias, audienca e synuar nga kjo lloj media ne publik/ aktoret politike;
2. Monitorimi i OSHMA-ve private bëhet sipas këtyre kriterëve
 - a. Monitorimi i OSHMA-ve private me shtrirje gjeografike kombëtare, satelitore dhe rajonale që mbulojnë minimalisht 48% të popullsisë bëhet bazuar në këto kriterë:
 - i. Monitorimi i përditshëm TV me format gjeneralist dhe informativ;
 - ii. Monitorimi i përditshëm i edicioneve informative, reklamave/ spoteve, debateve politike, apo programeve të përcaktuara në nenin 7 të këtij vendimi ku janë të ftuar përfaqësues të subjekteve politike/ zgjedhore, kandidatë për deputet/drejtues të organeve njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - iii. Monitorimi bëhet në të dhëna sasiore dhe cilësore referuar kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të KQZ-së.
 - b. Monitorimi i OSHMA-ve private me shtrirje rajonale që nuk plotësojnë kriterin e pikës a) bëhet me përzgjedhje në bazë të këtyre kriterëve:

- i. Zona e ofrimit të shërbimit (mbulimi gjeografik);
 - ii. Audiencia;
 - iii. Oraret e transmetimit;
 - iv. Formati i përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, i përgjithshëm/tematik;
 - v. Lloji i medias, audiencia e synuar nga kjo lloj media në publik/ aktorët politikë.
3. AMA me qëllim monitorimin e gjithë OSHMA-ve, bazuar në kapacitetet dhe mundësitë teknike për OSHMA-të të cilat do të monitorohen sipas shkronjës "b" të pikës 1 dhe shkronjës "b" të pikës 2 të këtij neni, i rekomandon çdo ditë të hënë, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numrin e kanaleve/ OSHMA-ve që do të monitorohen dhe i shpjegon arsyet e kësaj përzgjedhjeje.
 4. Në zonat kryesore gjeografike të populluara nga pakica kombëtare AMA monitoron edhe OSHMA-të lokale në bazë të përzgjedhjeve sipas pikës 3 të këtij neni.
 5. Për OSHMA-të lokale, që nuk mbulojnë nga mjetet monitoruese, AMA kërkon ruajtjen e programacionit dhe dërgimin e regjistrimeve në mënyrë elektronike dhe/ose në format CD/DVD/USB.

Neni 7

Programet që monitorohen nga AMA

1. Programet që monitorohen ndahen sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) edicione të zakonshme dhe të posaçme informative;
 - b) transmetimet e drejtpërdrejta (live);
 - c) spote/reklama;
 - d) titrimet bazuar në kampionatura në 2 orë transmetimi për TV informativ;
 - e) debate zgjedhore;
 - f) programet me përmbajtje informative/investigative;
 - g) programet me përmbajtje të ndryshme ku ftohen politikanë dhe që përcjellin mesazhe politike.
2. Monitorimi i OSHMA-ve gjatë fushatës zgjedhore bëhet nga ora 08:00-00:00 ose sipas rastit deri në përfundimin e programit.
3. AMA monitoron OSHMA-të publike për respektimin e rezultatit të shortit për minutazhin falas në dispozicion të subjekteve zgjedhore sipas nenit 80 të Kodit Zgjedhor.

Neni 8

Monitorimi i ofruesve të shërbimeve mediatike vendore

OSHMA-të vendore që nuk mbulojnë nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese.

Neni 9

Përmbajtja e raportit të monitorimit

1. Raporti i AMA-s duhet të përmbajë të dhëna sasiore dhe cilësore, duke përfshirë informacionin në vijim:

- a. OSHMA-të që janë monitoruar;
 - b. Llojin e platformës së transmetimit;
 - c. Kohën e monitorimit për çdo OSHMA
 - d. Minutazhin e transmetimeve zgjedhore të partive politike;
 - e. Minutazhin apo hapësirën që i jepet çdo aktori politik;
 - f. Kohën apo hapësirën që u jepet fjalimeve të drejtpërdrejta të çdo aktori politik ose intervistat me ta;
 - g. Radhën e vendosjes së kandidatëve apo partive në edicionet informative;
 - h. Raportin gjinor të mbulimit mediatik të kandidatëve;
 - i. Konkluzionet e monitorimit bazuar në treguesit e mbledhur nëse subjekti i monitoruar ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale.
2. Raporti i AMA-s brenda kapaciteteve organizative dhe logjistike të saj mund të përmbajë të dhënat cilësore në vijim:
 - a) Numrin e herëve që përdoret një fjalë e caktuar për të përshkruar një politikan të caktuar;
 - b) Numrin e grave kandidate, të përmendura në media; dhe
 - c) Numri i herëve që përmendet secili aktor politik (si p.sh.: një kandidat apo politikan tjetër);
 3. Monitorimin e kohës së transmetimit të reklamave politike gjatë periudhës zgjedhore në OSHMA-të private, të cilët pranojnë reklama me pagesë.
 4. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe dukshmërisë së kandidateve gra në fushatën zgjedhore, AMA do të monitorojë kohën falas në dispozicion të partive politike të regjistruara, si subjekte zgjedhore, nga Radiotelevizioni Publik Shqiptar, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore, sipas secilës gjini.

Neni 10

Paraqitja e raporteve të monitorimit në KQZ

1. AMA përpilon raporte ditore për monitorimin e fushatës zgjedhore në OSHMA-të dhe ia dërgon ato Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për t'i publikuar në faqen zyrtare:
 - a) Raporti i monitorimit sasior është ditor dhe pasqyron të dhënat e regjistrimeve të asaj dite dhe depozitohet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se ora 10:00 e ditës së nesërme të regjistrimit.
 - b) Raporti depozitohet në dy kopje, i printuar dhe në format elektronik.
2. AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara (sasiore dhe cilësore), minimalisht një herë në javë, të cilat ia paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetence.
3. Raportet shoqërohen, sipas rastit, me propozimet për masa administrative.
4. Raportet e monitorimit të OSHMA-ve publikohen në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve menjëherë sapo depozitohen në KQZ.
5. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të marrin kopje të këtij raporti pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komentet dhe propozimet e tyre para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat shqyrtohen bashkë me raportin.

7. Në rastet e konstatuara kryesisht ose në bazë të raportimeve, të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, AMA duhet të informojë menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në parimin e proporcionalitetit, urdhëron korrigjimin e sjelljes për OSHMA-të ose subjektet zgjedhore, ose, sipas rastit, vendos sanksione administrative ndaj tyre, mbështetur në gjetjet e veta, në ato të raporteve të monitorimit, si dhe në informacionet, ankimet apo denoncimet e palëve të treta, të verifikuara prej saj.

Neni 11 **Rishikimi administrativ i monitorimit**

1. Subjektet e monitoruara në bazë të raporteve ditore paraqesin pranë AMA-s kërkesat për rishikim të treguesve të monitoruar. Kërkesat duhet të jenë të argumentuara dhe të mbështetura në fakte dhe prova.
2. AMA jo me vonë se 2 ditë nga paraqitja e kërkesës për rishikim trajton kërkesën duke pranuar korrigjimin e treguesve ose refuzimin e kërkesës.

Neni 12 **Shqyrtimi i Raportit të Monitorimit**

1. Përfaqësuesi i AMA-s prezanton raportin javor para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhje publike.
2. Subjektet zgjedhore apo përfaqësuesi i OSHMA-ve kanë të drejtë të drejtojnë pyetje për përfaqësuesin e AMA-s, vetëm pas miratimit nga drejtuesi i mbledhjes.
3. Pas kësaj, subjektet zgjedhore dhe përfaqësuesit e OSHMA-ve, prezantojnë pretendimet/kërkesat e tyre që kanë depozituar para fillimit të mbledhjes.
4. Mbështetur në gjetjet e raporteve të monitorimit, si edhe informacionet, ankimet apo denoncimet e palëve të treta, të verifikuara prej saj, bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve urdhëron korrigjimin e sjelljes për OSHMA-të ose subjektet zgjedhore, ose sipas rastit vendos sanksione administrative.

Neni 13 **Paraqitja e raportit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrton raportet javore të monitorimit jo më pak se një herë në javë, gjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore.
2. Subjektet zgjedhore apo palët e treta që kanë pretendime/ankesa, për periudhën që përfshin raportin që shqyrtohet, duhet t'i depozitojnë ato në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve përpara fillimit të mbledhjes së radhës.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit administrativ të raporteve të monitorimit vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të monitorimit.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kryesisht ose me propozimin e AMA-s vendos edhe marrjen e masave administrative ndaj OSHMA-ve që kanë shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

5. Vendimi i Komisionarit Shtetëror i Zgjedhjeve përbën titull ekzekutiv dhe ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 14

Ankimi ndaj vendimit të Komisionarit Shtetëror të Zgjedhjeve

Vendimet e Komisionarit Shtetëror të Zgjedhjeve ankimohen brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankesave dhe Sanksioneve.

Neni 15

Dispozita të fundit

Ankimi dhe hyrja në fuqi

1. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë si dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Iirjana NANO-

Kryetare

Arens ÇELA-

Anëtar

Dritan ÇAKA-

Anëtar

Helga VUKAJ-

Anëtare

Muharrem ÇAKAJ-

Anëtar